

## CONCORDIA - POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE

### CONCORDIA- Mbrojtja e Fëmijëve

“Të gjithë fëmijët kanë të njëjtat të drejta, pavarësisht se kush janë, ku jetojnë, cilën gjuhë flasin, çfarë feje kanë, çfarë mendojnë, pamja, si identifikohen, nëse kanë nëse kanë ndonjë paaftësi, nëse janë të pasur apo të varfër, dhe pa marrë parasysh se cilët janë prindërit apo familjet e tyre apo çfarë besojnë dhe bëjnë prindërit apo familjet e tyre. Asnjë fëmijë nuk duhet të trajtohet me padrejtësi për asnjë arsye.”

Miratuar nga Bordi Ndërkombëtar i CONCORDIA Projekte Sociale

Vjenë, 22 mars 2018

(e përditësuar dhe e miratuar në dhjetor 2023)

*Dokumenti aktual u përpilua nga ana e znj. Mirela Lavric e u rishikua nga znj. Martina Raytchinova, nën përgjegjësinë e Departamentit të Programeve dhe Projekteve të CONCORDIA Projekte Sociale, me mbështetjen e Këshilltares së Lartë për Program, znj. Eva Okonofua dhe të Ekipit Ndërkombëtar të Udhëheqjes. Ne shprehim mirënjohjen tonë për të gjithë fëmijët, prindërit, vullnetarët, kolegët dhe partnerët nga të gjitha vendet e CONCORDIA's, të cilët vepruan si këshilltarë dhe që kontribuan me komente, pikëpamje dhe rekomandime.*

## Tabela e përmbajtjes]

Parathënie nga Bordi.....	3
<b>1. Prezantimi</b>	
1.1. Rreth CONCORDIA Projekteve Sociale .....	4
1.2. CONCORDIA- Deklarata për Mbrojtjen e Fëmijëve.....	5
1.3. Rreth këtij dokumenti.....	5
<b>2. Parimet që mbështesin Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve të CONCORDIA's</b> .....	6
<b>3. Qëllimet e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve</b> .....	7
<b>4. Legjislacioni përkatës</b> .....	8
<b>5. Përkufizimet</b> .....	9
<b>6. Veprimet parandaluese</b> .....	10
<b>6.1. Burimet njerëzore</b> .....	10
6.1.1. Stafi .....	11
6.1.2. Vullnetarët .....	11
6.1.3. Anëtarët e bordit .....	11
6.1.4. Rritja e ndërgjegjësimit, trajnimi dhe mbikëqyrja .....	12
<b>6.2. Ndërtimi i projekteve dhe programeve të sigurta për fëmijët</b> .....	12
6.2.1. Qasja e përqendruar tek fëmijët.....	12
6.2.2. Vlerësimi i rrezikut .....	13
6.2.3. Përgatitja e projekteve të reja .....	14
6.2.4. Partnerët.....	14
<b>6.3. Mediat dhe komunikimi</b> .....	14
<b>6.4. Burimet e fondeve</b> .....	15
<b>6.5. Vizitorët</b> .....	15
<b>6.6. Përdorimi i teknologjisë së informacionit</b> .....	16
<b>7. Veprime të përgjegjshme</b> .....	16
<b>7.1. Raportimi dhe reagimi ndaj akuzave për abuzimin e fëmijëve</b> .....	16
<b>7.2. Llogaridhënia, Monitorimi dhe Rishikimi i vëzhgimit të Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve</b> .....	17
<b>8. Kodi i Sjelljes</b> .....	18
<b>9. Shtojcat:</b>	
Deklarata e Angazhimit ndaj Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve të CONCORDIA's.....	20
Shtojca 1: Përkufizimet dhe njohja e shenjave të abuzimit.....	21
Shtojca 2: Kodi i Sjelljes.....	26

## Parathënie nga Bordi Ndërkombëtar

Me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bordi Ndërkombëtar i CONCORDIA's Projekte Sociale është duke dërguar një sinjal të qartë për fëmijët, të rinjtë dhe familjet që na u janë besuar. Me një fjalë, gjithçka që është në fuqinë tonë për t'i mbrojtur fëmijët nga çdo formë e dhunës dhe për të zhvilluar dhe zbatuar vazhdimisht masa innovative, si dhe për të mbajtur CONCORDIA'n si një organizatë e sigurisë për fëmijët.

Kjo politikë, e cila u adresohet të gjithë punëtorëve, vullnetarëve, mbështetësve dhe autoriteteve përkatëse, i përshkruan definicionet që ne kemi ndaj dhunës, mekanizmat e vendosura për të ndërhyrë dhe parandaluar dhunën brenda dhe jashtë organizatës, si dhe drejtime specifike për veprimin që ne kërkojmë. që fëmijët të mund të përjetojnë një fëmijëri dhe rini të sigurt, të lumtur dhe të vetëvendosur në ambientet e CONCORDIA's por edhe në mjedisin e tyre të afërt.

Ne po angazhohemi për vlerësimin e rregullt të masave të marra dhe përfshirjen e standardizuar të të gjithë punonjësve të CONCORDIA's në menaxhimin e personelit.

Ne pohojmë me krenari se shumë masa për mbrojtjen e fëmijëve janë vendosur tashmë në organizatë prej vitesh dhe kjo politikë për mbrojtjen e fëmijëve i konsolidon ato zyrtarisht (në të shkruar). Gjatë përpilimit të këtij dokumenti, ne konsultuam dhe intervistuam fëmijët, adoleshentët dhe familjet për të cilat kujdesemi, si dhe punonjëtorët e CONCORDIA's, duke rikonfirmuar rëndësinë e temës për organizatën.

Për më tepër, kjo politikë synon të adresojë ndryshimin e rrethanave që fëmijët aktualisht janë duke përjetuar në mjedisin e tyre, qoftë legjislativ i ri si *Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave*, apo realitetin e mediave sociale, i cili përbën një sfidë të madhe jo vetëm në punën e përditshme me fëmijët, por edhe në komunikim me mbështetësit dhe kërkon një rishqyrtim të kujdesshëm dhe riorientim të pjesërishëm të masave të zbatuara.

Politika përfshin një Kod specifik të Sjelljes dhe një listë masash që duhet të merren nga punëtorët e CONCORDIA's, në rast të çdo dyshimi të dhunës ndaj fëmijëve.

Të gjithë personat që punojnë në CONCORDIA Projekte Sociale janë shumë të vetëdijshëm se mbrojtja e fëmijëve që na është besuar është e mira më e madhe në sfidat e përditshme të punës sonë në të gjitha fushat dhe ka nevojë për momente reflektimi kritik dhe hapa të guximshëm në jetën e përditshme.

Një falenderim i veçantë të gjithë mbështetësve të CONCORDIA's që na ndihmuan dhe respektuan pozitën tonë!

Ulla Konrad  
Anetare e Bordit

## 1. Parathënie

Dhuna ndaj fëmijëve është një fenomen ndërkombëtar<sup>1</sup> që zhvillohet në mjedise dhe shoqëri të ndryshme. Fëmijët e të gjitha moshave janë në rrezik të përjetojnë ose janë dëshmitarë të disiplinës së dhunshme, abuzimit në familje, bullizmit në shkollë dhe abuzimit seksual, psikologjik apo ekonomik që mund të ndodhë në mjediset e tyre të përditshme: në shtëpi, në shkollë, në mjediset e kujdesit, në rrugë, në strehimore emergjente ose gjatë udhëtimeve shkollore. Autorët mund të jenë prindërit e tyre, anëtarë të tjerë të familjes, prindër kujdestarë ose kujdestarë të tjerë, mësues, personel mjekësor apo fëmijë të tjerë. Disa fëmijë janë veçanërisht të cenueshëm ndaj abuzimit për shkak të gjinisë, racës, origjinës etnike,

---

<sup>1</sup>Sipas Ndalimit të Dhunës në Fëmijëri: Raporti Global 2017 nga Iniciativa Globale "Njihni dhunën në fëmijëri", pothuajse 75% e të gjithë fëmijëve i nënshtrohen dhunës çdo vit.

paaftësisë, orientimit seksual, besimeve fetare ose statusit social. Si të rritur dhe si profesionistë, është përgjegjësia jonë të punojmë shumë për të parandaluar abuzimin e fëmijëve, t'i kushtojmë vëmendje dhe të njohim shenjat e abuzimit dhe ndryshimit të sjelljes, dhe t'u përgjigjemi këtyre shenjave në kohë dhe në mënyrë të përshtatshme.

### 1.1. Rreth CONCORDIA Projekte Sociale

CONCORDIA Projekte Sociale (në vijim e referuar si CONCORDIA) është një organizatë ndërkombëtare, e pavarur, joqeveritare e pranishme në Austri, Bullgari, Kosovë, Rumani, Republikën e Moldavisë, Gjermani dhe Zvicër. Zyrat kombëtare në çdo vend ofrojnë shërbime sociale dhe arsimore të përkushtura për të mbështetur fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë në rrugën e tyre drejt një jete të pavarur dhe të përgjegjshme. CONCORDIA punon me grupe të ndryshme të synuara dhe ofron një shërbime të ndryshme. Ne i përforcojmë familjet në rrezik dhe parandalojmë ndarjen e familjes me ndihmën e shërbimeve tona në Qendrat ditore dhe puna e komunitetit në terren. I mbështesim fëmijët dhe të rinjtë që janë ndarë nga familjet e tyre për arsye të ndryshme dhe kanë nevojë akute për një mjedis familjar të sigurt dhe ushqyes përmes shërbimeve tona të ngjashme me familjen. CONCORDIA ndihmon fëmijët dhe nënat me fëmijë të vegjël me përvojë abuzimi duke u ofruar strehim të mbrojtur në qendrat e krizave dhe duke ofruar ndërhyrje urgjente për raste urgjente mbrojtëse. Ne mbështesim adoleshentët dhe të rinjtë e fokusuar në komponentin arsimor dhe zhvillimin e aftësive të jetës në rrugën drejt një jetese të vetëvendosur përmes ofrimit të shërbimeve në qendra profesionale, qendra për zhvillimin e aftësive jetësore dhe apartamente të përkohshme dhe të mbikëqyrura.

#### Misioni dhe vizioni ynë

- CONCORDIA është një organizatë ndërkombëtare e pavarur, e dedikuar për të ndihmuar fëmijët, të rinjtë dhe familjet në nevojë.
- CONCORDIA shoqëron fëmijët dhe të rinjtë në rrugëtimin e tyre drejt një jete të vetëvendosur. Ne hapim mundësi përmes arsimit dhe formimit profesional dhe ndihmojmë të rinjtë të marrin aftësitë e nevojshme për një jetë të pavarur me dinjitet dhe jashtë marginalizimit.
- Aktivitetet e CONCORDIA's kontribuojnë drejt luftës së thyerjes së rrethit të varfërisë së brezave. Shkojmë aty ku ka më shumë nevojë.
- Ne orientohemi drejt vlerave tona thelbësore të cilat janë të ngulitura në të gjitha politikat organizative: lidhja me zemër, përkushtimi, guximi dhe mundësitë.
- CONCORDIA udhëhiqet nga Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Njeriut si dhe nga Siguria Evropiane për Fëmijët. Ne kontribuojmë në krijimin e një shoqërie të hapur, elastike dhe të bashkuar.

### 1.2. Deklarata e CONCORDIA's për mbrojtjen e fëmijëve

CONCORDIA u mundëson fëmijëve të gëzojnë një fëmijëri të lumtur dhe të shëndetshme. Puna e saj është e ankoruar në **Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve** (KKBDF, 1989). Të gjitha organizatat e CONCORDIA's e mbështesin dhe ndajnë angazhimin e përbashkët për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike, ekonomike dhe psikologjike, neglizhencës, keqtrajtimit dhe

shfrytëzimit, duke përfshirë abuzimin seksual.<sup>2</sup> dhe trafikimin e fëmijëve. Puna e CONCORDIA's, synon të mbrojë të gjitha të drejtat e fëmijëve siç është e përcaktuar në KKBDP-ën, si dhe në legjislacionin kombëtar për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në vendet në të cilat ofrohen shërbimet tona. Në të gjitha veprimet që marrim me dhe për fëmijët, CONCORDIA angazhohet të mbrojë fëmijët dhe të raportojë e t'i përgjigjet çdo abuzimi të supozuar, duke marrë masat e nevojshme siç përcaktohet në politikat dhe procedurat e brendshme kombëtare, pavarësisht nga burimi i referimit dhe nga i dyshuari. Parimi **mos lëndo** është një parim qendror i filozofisë së organizatës.

***Në CONCORDIA objektivi ynë është që 100% e rasteve të raportuara rreth mbrojtjes së fëmijëve, paraprisht hetohen dhe se masat adekuate janë të duhura.***

### 1.3. Rreth këtij dokumenti

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve të CONCORDIA's, u zhvillua përmes një procesi stimul- reagim (botton-up process) dhe konsultimeve të shumta me fëmijët, të rinjtë, anëtarët e familjes, bashkëpunëtorët, stafin drejtues, vullnetarët dhe partnerët, ngase ne e vlerësojmë opinionet, besimet, ndjenjat dhe përvojat e tyre. Politika është fundamentale (themelore) në misionin tonë, vlerat, qasjet dhe shërbimet, dhe si e tillë duhet të respektohet nga të gjithë punonëtorët, vullnetarët, anëtarët e bordit, donatorët, vizitorët si dhe nga fëmijët dhe të rinjtë në organizatë. Politika është zhvilluar për të siguruar standardet më të larta të sjelljes profesionale dhe praktikës personale, në mënyrë që të mos shkaktohet asnjë dëm fëmijëve dhe të rinjve gjatë përfshirjes së tyre në aktivitete, projekte dhe programe brenda organizatës.

## 2. Parimet që mbështesin Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve të CONCORDIA's

***Mbrojtja e fëmijëve është përgjegjësi organizative që siguron që stafi, veprimet dhe programet e tyre të mos i ekspozojnë fëmijët ndaj rrezikut të çdo lloj dëmtimi dhe abuzimi, dhe se çdo shqetësim që organizata ka në lidhje me sigurinë e fëmijëve brenda komuniteteve në të cilat ata punojnë i raportohet autoritetet përkatëse.***

***“Mos lëndo” është një parim që është përdorur në sektorin humanitar, por mund të zbatohet në mënyrë të barabartë në fushën e zhvillimit. Ai i referohet përgjegjësisë së organizatave për të minimizuar dëmin që mund të bëjnë pa dashje si rezultat i aktiviteteve të tyre organizative.<sup>3</sup>***

Parimet e mëposhtme janë themelet e kësaj politike:

- Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë e përfshirë në aktivitetet, projektet dhe programet tona kanë të drejta të barabarta për t'u mbrojtur nga çdo formë dhune, dhe se interesi dhe mirëqenia e tyre gjithmonë merren parasysh;

<sup>2</sup>Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (1989), Neni 19 b

<sup>3</sup> Koalicioni Mbrojtja e Fëmijëve të Sigurt 3: [www.keepingchildrensafe.org.uk](http://www.keepingchildrensafe.org.uk)

- Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë dinë për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre ndaj të tjerëve;
- Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pyeten dhe konsultohen në lidhje me vendimet që i prekin dhe mendimet e tyre merren si parësore;
- Ne vlerësojmë dhe respektojmë të gjithë fëmijët në kontekstin e kulturës, fesë dhe përkatësisë etnike të tyre;
- Punën tonë për fëmijët e bëjmë në partneritet me autoritetet, shkollat, kopshtet dhe OJQ-të e tjera. Partneritetet tona kryhen në një mënyrë të besueshme, transparente dhe afatgjatë, dhe për këtë arsye qasjen **mos i lëndoni fëmijët** presim nga të gjithë partnerët tanë.

[Grab your reader's attention with a great quote from the document or use this space to emphasize a key point. To place this text box anywhere on the page, just drag it.]



Menaxhimi i rastit të Mbrojtjes së Fëmijëve

### 3. Qëllimet e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve

**CONCORDIA** punon me fëmijët dhe të rinjtë të cenusur dhe në të gjitha aktivitetet dhe vendimet e marra ne i qasemi interesit më të mirë të fëmijës si pikë kryesore e referimit. Shërbimet që ne ofrojmë për fëmijët në organizatat kombëtare funksionojnë sipas dispozitave ligjore kombëtare.

#### Qëllimet e politikës janë:

- Për të siguruar që 100% e rasteve të hetohen, të merren masat adekuate dhe të sigurohet siguria e palëve të përfshira;
- Të ketë staf dhe vullnetarë të trajnuar dhe të informuar për sjelljen etike ndaj fëmijëve, për të parandaluar shkeljen e të drejtave të fëmijëve, për të identifikuar çdo shenjë abuzimi ndaj fëmijëve dhe për t'i raportuar ato;

- Të ketë respekt ndaj të drejtave të fëmijëve dhe të sigurojë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për ta nga të gjithë individët që bashkëpunojnë me CONCORDIA'n, në cilësinë e anëtarëve të Bordit, konsulentëve, kontraktorëve, partnerëve, sponsorëve dhe donatorëve, të ftuar dhe vizitorë, gazetarë, animatorë apo (persona) shoqërues;
- Të informohen të gjithë pjesëmarrësit e programit CONCORDIA për të drejtat e tyre dhe të ndjekin sjelljen e duhur ndaj bashkëmoshatarëve, kolegëve, vullnetarëve dhe anëtarëve të familjes;
- Të jemi një organizatë e sigurt për fëmijët e përkushtuar për të trajtuar abuzimin e fëmijëve dhe të ofrojmë garancion (siguri) për prindërit, donatorët dhe publikun e gjerë për cilësinë, efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e punës sonë;
- Të sigurojë që çdo rast dhune dhe abuzimi ndaj fëmijëve të raportohet menjëherë, pavarësisht nëse është rast i dyshuar apo aktual;
- Të krijojë dhe të mbajë mekanizma të besueshëm raportimi dhe reagimi për të parandaluar çdo lloj lëndimi ndaj fëmijëve brenda dhe jashtë organizatës.

*Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve është plotësuese e të gjitha politikave dhe procedurave të organizatës sonë dhe shoqërohet nga një Doracak i detajuar i Politikave për Mbrojtjen e Fëmijëve të CONCORDIA's, si një dokument kryesor udhëzues për zbatimin e politikës në praktikë.*

#### 4. Legjislacioni përkatës

Politika e CONCORDIA's për mbrojtjen e fëmijëve bazohet në Konventat, Udhëzimet dhe Ligjet e mëposhtme:

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, 1989<sup>4</sup>
- Standardet për mbrojtjen e fëmijëve të përcaktuara nga Koalicioni Mbajtja e Fëmijëve të Sigurt, 2014
- Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Abuzimit dhe Shfrytëzimit Seksual, 2017
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Kujdesin Alternativ të Fëmijëve, 2010
- Komisioni Evropian, Axhenda Evropiane për Migracionin, 2015
- Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Shfrytëzimit Seksual dhe Abuzimit Seksual, e njohur edhe si "Konventa e Lanzarotes", 2007
- Legjislacioni kombëtar për të drejtat e fëmijëve nga Austria, Bullgaria, Kosova, Moldavia dhe Rumania
- Konventa e OKB-së, për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave (EFDG-ja) e cila Konventë nuk e mbulon drejtpërdrejt mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, por thekson eliminimin e diskriminimit ndaj grave në çështjet familjare, duke i dhënë përparësi interesave më të mira të fëmijëve; Rekomandimi i Përgjithshëm Nr.35 thekson marrjen parasysh të të drejtave të grave dhe fëmijëve për jetën dhe integritetin, duke i dhënë përparësi interesit më të mirë të fëmijës në procedurat ligjore që përfshijnë të drejtat e autorëve të krimit.
- Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) është instrumenti i parë ligjor i detyrueshëm evropian për të luftuar dhunën ndaj grave dhe vajzave, i cili njih fëmijët si viktime të dhunës në familje, siguron fushata ndërgjegjësimi publik për forma të ndryshme të dhunës që ndikojnë tek fëmijët, kërkon shërbime të specializuara mbështetëse për gratë viktime dhe fëmijët e tyre, përcakton masa mbrojtëse për fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës dhe kërkon që të merret në konsideratë ndikimi i dhunës në përcaktimet e paraburgimit, duke siguruar vlerësime të sigurisë dhe

<sup>4</sup>Data e nënshkrimit nga Austria, Gjermania dhe Rumania ishte 26 janar 1990; Bullgaria e nënshkroi atë më 31 maj 1990 dhe Republika e Moldavisë e ratifikoi më 26 janar 1993 dhe Republika e Kosovës më 27 qershor 2019.

menaxhimin e rreziqeve që lidhen me dhunën e përsëritur, duke përfshirë vlerësimin e aksesit të autorit ndaj armëve të zjarrit.

- Akti themelues i të Drejtave Themelore të BE-së, siguron mbrojtjen dhe kujdesin për mirëqenien e fëmijëve, duke theksuar të drejtën e tyre për t'u dëgjuar dhe për t'u marrë në konsideratë pikëpamjet e tyre bazuar në moshën dhe pjekurinë e tyre, ku ndërkohë i jep përparësi interesit më të mirë të fëmijës në të gjitha veprimet në lidhje me të drejtat e fëmijëve.
- Udhëzimi i BE-së, për të Drejtat e Viktimave (Udhëzimi 2012/29/BE) siguron të drejta dhe mbrojtje për të gjitha viktimat e krimit, duke pranuar veçanërisht nevojat e atyre që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore dhe fëmijë viktimë; ai siguron të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar në procedimet penale, mbron privatësinë e tyre dhe supozon se fëmija me përvojë dhune ka nevoja specifike për mbrojtje për shkak të cenueshmërisë së tyre, duke inkurajuar veprime ndërgjegjësuese në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile për të zbutur rreziqet dytësore, viktimizimi, frikësimi dhe hakmarrja.
- Udhëzimi i BE-së, për luftën kundër abuzimit seksual dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe materialeve të abuzimit seksual të fëmijëve (Udhëzimi 2011/92/BE) fokusohet në parandalimin e krimeve të tilla, vendosjen e rregullave minimale për përcaktimin e veprave penale dhe dënimet për autorët, dhe sigurimin e mbrojtjes për fëmijët viktimë për të luftuar dhe mbrojtur në mënyrë efektive kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual.
- Strategjia e Këshillit të Evropës për të drejtat e fëmijës 2022–2027 thekson drejtësinë miqësore për fëmijët, duke nxitur përshtatjen e procedurave ligjore për të përmbushur nevojat specifike të fëmijëve dhe për të parandaluar ritraumatizimin dhe riviktimizimin e tyre, duke theksuar rëndësinë e një kuadri që i jep përparësi mirëqenies së fëmijëve brenda proceseve ligjore.

## 5. Përkufizimet

*Mbrojtja e fëmijëve është mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi dhe neglizhenca siç përcaktohet në nenin 19 të KKBDF -sës (Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve) i cili thekson se shtetet palë duhet të kenë ligje të duhura për të ndaluar dhunën dhe për të zbatuar masa administrative, sociale dhe edukative për mbrojtjen e fëmijëve. Në kontekstin aktual, termi nënkupton detyrën e organizatës dhe të punëtorëve, bashkëpunëtorëve dhe vullnetarëve të saj për të mbrojtur fëmijët në kujdesin e tyre nga dëmtimi i qëllimshëm dhe i paqëllimshëm. Mbrojtja e Fëmijëve është pjesë e të gjithë procesit të mbrojtjes që një organizatë zbaton për të parandaluar lëndimet e fëmijëve dhe për t'u përgjigjur në rastet e lëndimit.*

Sipas përkufizimit që përmban neni 1 i Konventës së OKB-së, për të Drejtat e Fëmijës: “Fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç, përveç rastit kur, sipas ligjit në fuqi për fëmijën, mosha madhore arrihet më herët”. Megjithatë, politika aktuale zbatohet për të rinjtë mbi 18 vjeç që marrin pjesë në shërbimet CONCORDIA's, sipas legjislacionit kombëtar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

“Dhuna ndaj fëmijëve” është "çdo formë e dhunës fizike apo mendore, lëndimit dhe abuzimit, neglizhenca apo trajtimet e pakujdesshme, keqtrajtimet apo shfrytëzimet, duke përfshirë abuzimin seksual", sipas nenit 19 të KKBDF -sës. Raporti Botëror mbi Dhunën dhe Shëndetin (2002) e përkufizon dhunën ndaj fëmijëve si “përdorim i qëllimshëm i forcës fizike ose autoritetit, i/e kërcënuar ose aktual, kundër një fëmije, nga një individ ose grup, që rezulton apo ka një gjasë të lartë për të rezultuar në lëndim aktual ose të mundshëm për shëndetin, mbijetesën, zhvillimin apo dinjitetin e fëmijës.”



**CONCORDIA përcakton dhunën ndaj fëmijëve** si çdo formë e dëmtimit fizik dhe psikologjik (mendor dhe emocional) ndaj fëmijëve, abuzim seksual, neglizhencë, ngacmim, shfrytëzimi ekonomik, shfrytëzimi nëpërmjet punës, shfrytëzimi seksual, rrëmbimi dhe/apo zhdukja, migrimi i rrezikshëm, trafikimi, dhuna në internet dhe kujdesi, materiali dhe burimi i abuzimit të fëmijëve (seksual), abuzimi seksual i bazuar në imazhe, i cili përfshin shpërndarjen me dhe pa internet dhe atë pa consensus, imazhe ose video reale apo falso (mashtroese). Dhuna ndaj fëmijëve mund të ndodhë në familje, në shkollë, në sistemin shëndetësor, në sistemin e specializuar të mbrojtjes së fëmijëve (kujdestar/familje strehuese, shtëpi të tipit familjar, qendra vendosjeje), shërbime të tjera si kujdesi ditor, qendrat komunitare dhe pas shkollës, online, në (mas) media, në aktivitete të kohës së lirë, udhëtime apo kampe- përfshin dhunën e ushtruar ndaj fëmijëve nga të rriturit (prindërit dhe kujdestarët), si dhe dhunën nga bashkëmoshatarët. Si shtesë, këtu përfshihen fëmijët që dëshmojnë dhunë në mediat e a lartëpërmendura. **Disiplina e dhunshme në shtëpi (në familje ose në forma alternative të kujdesit) është forma më e zakonshme e dhunës** me përvojë nga fëmijët. Shumë kujdestarë mbështeten në përdorimin e metodave të dhunshme, fizike dhe psikologjike, për të ndëshkuar sjelljen e padëshiruar dhe për të inkurajuar atë të dëshiruar. Kujdestarët nuk e përdorin domosdoshmërisht këtë lloj disipline me qëllim të qëllimshëm për t'i shkaktuar dëm ose lëndim fëmijës, por ata e bëjnë këtë nga zemërimi, zhgënjimi, mungesa e të kuptuarit apo mungesa e njohurive për metodat jo të dhunshme të rritjes së një fëmije.

## 6. Veprimet parandaluese

**CONCORDIA** është e përkushtuar për të krijuar një mjedis të sigurt për fëmijët dhe për të garantuar mirëqenien e tyre dhe interesin e tyre më të mirë. Një nga fokuset thelbësore të punës sonë është ndërgjegjësimi dhe parandalimi, të cilat në radhë të parë ulin rrezikun e rastit të dhunës ndaj fëmijëve. Kjo politikë, së bashku me procedurat për zbatimin e saj (siç përcaktohen në Doracakun Operativ të Mbrojtjes së Fëmijëve të CONCORDIA's), janë zbatuar gjerësisht midis stafit, vullnetarëve, partnerëve dhe fëmijëve tanë dhe janë integruar fort në kulturën tonë organizative. Vëmendje e veçantë i kushtohet rasteve të bullizmit dhe abuzimit nga bashkëmoshatarët. Këto raste janë hetuar nga afër me mbështetjen e të dyja palëve të përfshira.

### 6.1. Burimet njerëzore

Politika e CONCORDIA's për Mbrojtjen e Fëmijëve zbatohet për të gjithë stafin, anëtarët e bordit, vullnetarët, bashkëpunëtorët dhe ekspertët afatshkurtër apo të përkohshme, vendimtarë kryesorë, respektivisht qoft ajo kontaktë civile apo si ofruet i shërbimeve me CONCORDIA'n.

#### 6.1.1. Stafi i CONCORDIA's

Politikat e Burimeve Njerëzore të CONCORDIA's prezanton masat specifike për të siguruar zbatimin e parimeve të Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve në të gjitha nivelet. Duke filluar nga faza e rekrutimit, ne promovojmë dhe theksojmë çartë **tolerancën zero** të CONCORDIA's të ndaj abuzimit me fëmijët, duke e specifikuar në shpalljen e konkursit.<sup>5</sup> Në çdo përkrahim i punës, CONCORDIA shpreh çartë ndalimin e abuzimit të fëmijëve dhe përmban Kodin tonë të Sjelljes në Aneks.

Udhëzimet e CONCORDIA's për përzgjedhjen e punëtorit/punëtores janë të detyrueshme në nivel ndërvendor. Ndër të tjera, këtu përfshihen të dhënat kriminalistike dhe mjekësore si dhe referencat nga

<sup>5</sup>Për punësim, kandidatët do të paraqesin dosjen penale dhe rezultatin e ekzaminimit mjekësor të punës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për këtë fushë të veprimtarisë.

punëdhënësit e mëparshëm. Për pozicionet që përfshijnë punë të drejtpërdrejtë me fëmijët, ekziston një intervistë e dytë e detyrueshme dhe periudha e vëzhgimit (shadowing period). Poashtu, indikatorët e performancës për mbrojtjen e fëmijëve lejojnë organizatën të gjurmojë zbatimin e rregulloreve nga të gjithë punonëtorët dhe këta indikatorë monitorohen çdo gjashtë muaj.

Në gjashtë javët e para të punësimit, të gjithë anëtarët e rinj të ekipit të CONCORDIA's, kalojnë nëpër një program intensiv të integritit (onboarding), e cila përbëhet nga trajnimet mbi rolet dhe përgjegjësitë, nevojat e fëmijëve, njohja e shenjave të abuzimit dhe cilët mekanizma të raportimit janë në fuqi. Me rastin e shkeljes së Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve apo të Kodit të Sjelljes, organizata rezervon të drejtën t'i zgjidhë menjëherë kontratën punëtorit. Me rastin e dhunës ndaj fëmijëve, organizata është e detyruar të informojë autoritetet përkatëse.

Të gjithë punëtorët dhe bashkëpunëtorët e rinj me kontrata civile apo shërbimi, janë të detyruar të marrin pjesë në seancat mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve si pjesë e periudhës së tyre të hyrjes në bord. Punëtorët dhe bashkëpunëtorët aktualë marrin pjesë në seanca të rregullta informimi dhe trajnimi mbi Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Kodin e Sjelljes. Çdo shkelje e Kodit të Sjelljes apo çdo sjellje që është në kundërshtim me politikën aktuale duhet të hetohet dhe duhet të merren masa sipas politikave të BNJ-së, Rregullave të Brendshme dhe legjislacionit kombëtar dhe kjo mund të vazhdojë në dënime, pezullim apo shkarkim.

**CONCORDIA** i cakton Pikat Fokale përkatëse për Mbrojtjen e Fëmijëve (PFMF) në çdo zyrë kombëtare, roli i të cilave është të monitorojë nga afër përmbushjen e rregulloreve për mbrojtjen e fëmijëve në terren. PFMF-të, janë pika e parë të kontaktit për pjesëmarrësit dhe punonëtorët e programit në lidhje me pyetjet dhe shqetësimet që lidhen me Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF-ja). Pikat Fokale u ofrojnë trajnime (i trajnojnë) të gjithë punonëtorët dhe vullnetarët e rinj, mbajnë shënime të detajuara për temat e mbrojtjes së fëmijëve, kanë takime të rregullta me Zyrtarët Ndërkombëtar të Mbrojtjes së Fëmijëve<sup>6</sup> dhe marrin përditësime në seminare. Në rast se PMFM-ja, nuk është përkohësisht në dispozicion, përcaktohet një Person i Besueshëm në çdo qendër, i identifikuar individualisht për dhe nga çdo fëmijë. Personi i Besueshëm është një punonëtorë i CONCORDIA's me të cilin/cilën fëmija ndihet rehat duke biseduar në rast se ndihet i pasigurt në një situatë të caktuar apo në prani të një personi të caktuar. Personi i Besueshëm është i/e detyruar t'i komunikojë me PMFM-në, rreth pretendimeve të mundshme të abuzimit dhe shqetësimet ku në vazhdim, vendosin për procedurat dhe hetimin interne.

### 6.1.2. Vullnetarët

CONCORDIA i përcjell udhëzimet e interne për përzgjedhjen e vullnetarëve, duke përfshirë kërkesën për të dhënat kriminalistike dhe mjekësore nga vullnetarët dhe referenca nga punëdhënësit apo mësuesit e mëparshëm. Të gjithë vullnetarët janë të detyruar të lexojnë dhe të nënshkruajnë Kodin e Sjelljes dhe Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve. Në gjashtë javët e para të detyrës së tyre, vullnetarët ndërmarrin një program intensiv të integritit (onboarding) duke mësuar mbi rolet e brendshme, përgjegjësitë dhe kufizimet, nevojat e fëmijëve, njohjen e shenjave të abuzimit dhe mekanizmat e raportimit të të mësuarit. Nëse vullnetari/vullnetarët bien ë kundërshtim me sjelljet e Kodit të Mirësjelljes dhe politikave aktuale, atëherë CONCORDIA rezervon të drejtën e ndërprerjes së kontratës së tyre vullnetare në çdo moment dhe kohë.

### 6.1.3. Anëtarët e Bordit

<sup>6</sup>Profili i Rolit të Oficerit Ndërkombëtar të Mbrojtjes së Fëmijëve CONCORDIA:

[https://www.concordia.or.at/fileadmin/user\\_upload/DACH/Files/CONCORDIA-RoleProfile-InternationalChildProtectionOfficer.pdf](https://www.concordia.or.at/fileadmin/user_upload/DACH/Files/CONCORDIA-RoleProfile-InternationalChildProtectionOfficer.pdf)

Të gjithë anëtarët e Bordit të CONCORDIA's, angazhohen për të përmbushur Politikën e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Kodin e Sjelljes të organizatës. Ata kanë përgjegjësinë e përgjithshme për të mbikëqyrur dhe siguruar zbatimin e politikës brenda organizatave kombëtare. Një herë në vit, Bordi merr një raport mbi mbrojtjen e fëmijëve të përgatitur nga ekipi i menaxhimit me mbështetjen e PFMF-së, e përpiluar dhe e miratuar nga Zyrtari Ndërkombëtar i Mbrojtjes së Fëmijëve. Rezultatet e analizuara pasohen nga plani vjetor i veprimit për mbrojtjen e fëmijëve, i cili monitorohet në baza tremujore.

#### 6.1.4. Rritja e ndërgjegjësimit, trajnimi dhe mbikëqyrja

CONCORDIA siguron që Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve të kuptohet me saktësi nga të gjithë ata për të cilët zbatohet politika. Politika është përkthyer në gjuhët e organizatave vendore (duke përfshirë gjuhën ukrainase për shkak të ngjarjeve të fundit). Trajnimi dhe mbikëqyrja janë thelbësore për mbrojtjen e fëmijëve në organizatë, prandaj të gjithë punonëtorët e rinj, kontraktorët civilë dhe të shërbimeve, ekspertët me kohë të shkurtër ose të përkohshëm, vullnetarët dhe anëtarët e Bordit marrin një trajnim mbi Politikën organizative të Mbrojtjes së Fëmijëve. Trajnim është i përshtatur për rolet dhe përgjegjësitë e tyre specifike ndaj fëmijëve brenda tre muajve të parë të detyrës së tyre. Për punonëtorët/vullnetarët/ekspertët/bashkëpunëtorët aktualë është kryer një analizë e të mësuarit me qëllim të kuptimit dhe identifikimit të kërkesave mësimore që do t'u mundësojnë atyre të përmbushin dhe të zbatojnë dispozitat e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe procedurat e zbatimit të saj. Është përpiluar një kurrikulë (e detajuar) e trajnimit e përshtatur për nevojat e identifikuara të mësimin. Të gjithë punonëtorët duhet të dinë rolet, përgjegjësitë dhe mekanizmat për parandalimin e abuzimit të fëmijëve dhe për raportimin dhe reagimin ndaj akuzave për abuzimin e fëmijëve. Një fushë e gjerë aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve dhe shkëmbimi janë pjesë e portofolit të organizatës dhe të gjithë punonëtorët inkurajohen të marrin pjesë në mënyrë proaktive.

Për të gjithë punonëtorët organizohen trajnime vjetore dhe ofrohen informata mbi mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë sistemet e ndërgjegjësimit dhe të raportimit. Poashtu, personeli me përgjegjësi të veçanta ndaj fëmijëve përfiton vazhdimisht nga një program mbikëqyrjeje i cili përmban raste studimore dhe zgjidhje të ndryshme ku diskutohen qasjet dhe sfidat. Një politikë miqësore për fëmijët u elaborua me mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve<sup>7</sup>. Fëmijët marrin pjesë nëpër seanca të përshtatshme për moshën dhe nivelin e tyre të kuptuarit. Dokumenti shoqërohet me një video të përshtatshme për fëmijët<sup>8</sup> duke synuar të rinjtë dhe duke u fokusuar në të drejtat kryesore të fëmijëve. Të dy materialet janë në dispozicion në gjuhët e organizatave vendore. Një kërkesë e detyrueshme për një marrëveshje partneriteti me CONCORDIA'n, është përkushtimi ndaj politikës së "**tolerancës zero ndaj abuzimit**". CONCORDIA siguron që të gjithë që kanë lidhshmëri me organizatën, të kenë të qartë se çka është abuzimi dhe çdo ndërlikim në zhvillimin mendor dhe fizik të fëmijëve dhe mirëqenien e tyre emocionale.

## 6.2. Ndërtimi i projekteve dhe programeve të sigurta për fëmijët

### 6.2.1. Qasja e fokusuar tek fëmijët

Angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve në proceset, aktivitetet dhe vendimet që kanë të bëjnë me ta është një karakteristikë qendrore që i bën projektet dhe programet tona më efektive dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave individuale të fëmijëve. Ne inkurajojmë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve duke u ofruar

<sup>7</sup>Politika e CONCORDIA për mbrojtjen e fëmijëve – Version miqësor për fëmijët:

[https://www.concordia.or.at/fileadmin/user\\_upload/DACH/Files/Kinderschutzrichtlinie/PPP-childfriendly.pdf](https://www.concordia.or.at/fileadmin/user_upload/DACH/Files/Kinderschutzrichtlinie/PPP-childfriendly.pdf)

<sup>8</sup>Video CONCORDIA mbi të drejtat e fëmijëve: <https://youtu.be/6mS2E2waYk>

atyre mundësinë e organizimit në këshillat e fëmijëve, ku ata mund të mësojnë se si të flasin për veten e tyre dhe të angazhohen në vendimet në lidhje me jetën e tyre.

Ne presim që stafi ynë të vëzhgojë fëmijët dhe të bisedojë me ta për të zbutur rastet kur fëmijët kanë frikë të flasin për bullizmin apo diskriminimin që u ndodh atyre ose bashkëmoshatarëve të tyre në shkollë apo në lagjen e tyre. Në këtë drejtim, ne respektojmë parimet e mëposhtme kur bëhet fjalë për punën me fëmijët:

- **Vetëm fëmija vendos për trupin e tij/të saj:** të rriturit duhet të mësojnë të respektojnë trupin e fëmijëve dhe të mos i prekin, përqafojnë, puthin apo ngrenë lart pa i kushtuar vëmendje shenjave verbale ose joverbale të fëmijëve dhe pa pëlqimin e fëmijës. Një fëmijë ka të drejtë të pranojë dhurata pa pasur nevojë të përqafojë dhe puth dhuratëdhënësin. Fëmijët duhet të mësohen se janë unikë dhe të dashur dhe se kanë të drejtë të vendosin për trupin e tyre dhe t'i thonë **jo** prejkes së padëshiruar.
- **Ndjenjat e fëmijës janë të vlefshme dhe të rëndësishme:** fëmijët duhet të dinë se mund dhe duhet të ndihen ndryshe nga prindërit, kujdestarët, të rriturit apo moshatarët e tyre. Me këtë njohuri dhe duke marrë parasysh ndjenjat e tyre, është më e lehtë për ta, të shmangin momentet e pakëndshme pa pasur frikë se mos refuzohen. Një hap kyç drejt mbrojtjes kundër abuzimit seksual është inkurajimi i fëmijëve për të shprehur ndjenja të pakëndshme. Pjesët dhe veprimet e trupit duhet të emërtohen saktësisht dhe pa tabu. Në këtë mënyrë, ne mundemi në kohë njohin veprimet që fëmija i përjeton si shqetësuese dhe të pakëndshme dhe reagon ndaj tyre në përputhje me rrethanat. Fëmijët duhet të mbështeten në përcaktimin e tyre se cilat prekje janë të këndshme për ta e cilat jo.
- **Fëmijët kanë të drejtë të thonë “jo”:** fëmijët duhet të mësojnë të perceptojnë nevojat e tyre dhe të vendosin kufijtë e tyre në situatat e përditshme. Të rriturit duhet t'i fuqizojnë ata që ta bëjnë këtë dhe të respektojnë këto kufij për t'i përgatitur ata të mbrohen kundër çdo kërcënimi. Sigurisht që, duhet t'i kushtojmë vëmendje situatave në të cilat kontakti i ngushtë fizik mund të jetë i pakëndshëm, por i pashmangshëm, siç është vizita tek mjeku. Kur fëmijët mësojnë të vendosin kufijtë e tyre, ata gjithashtu mësojnë të respektojnë kufijtë e të tjerëve.
- **Ka sekrete të mira dhe sekrete të këqija:** shtë e rëndësishme t'i mësoni fëmijët dhe t'i ndihmoni ata të kuptojnë dallimin midis sekretëve të fëmijëve (surpriza, shaka me bashkëmoshatarët) shantazhin dhe ryshfetin. Fëmijët duhet të inkurajohen të ndajnë sekretet shqetësuese që u janë besuar duke mos ndier ndonjë faj.
- **Ku të kërkoni ndihmë:** fëmijët shpesh gjenden në situata kur nuk mund t'ia dalin dot vetë. Ata shpesh u drejtohen të rriturve që mund të mos i marrin seriozisht fjalët e tyre ose t'i besojnë ato. Fëmijët duhet të inkurajohen që të mos dorëzohen dhe të kërkojnë mbështetje. Duhet të dinë se është e drejta e tyre të kërkojnë ndihmë dhe duhet të jenë të vetëdijshëm se ku ta gjejnë atë, p.sh. PFMF-ja apo Personi i Besueshëm.
- **Nuk është faji i fëmijës:** fëmijët që abuzohen shpesh përjetojnë ndjenjën e fajit të imponuar nga dhunuesi në mënyrë që të mos flasin për përvojën e dhunshme. Interesat më të mira të fëmijës duhet të jenë konsiderata kryesore në të gjitha çështjet që i përfshijnë apo i prekin ata. Nëse ka një shqetësim mbrojtës, njerëzit duhet të përfshihen vetëm në bazë të nevojës për të ditur.

### 6.2.2. Vlerësimi i rrezikut

CONCORDIA është e përkushtuar për planifikimin, hartimin dhe ofrimin e projekteve dhe programeve që janë të sigurta për të gjithë fëmijët, pjesëmarrësit e programit dhe punëtorët. Gjatë fazës së planifikimit të projekteve të reja, ne kryejmë vlerësimin e nevojave dhe rrezikut së bashku me pjesëmarrësit e

programit dhe komunitetet. Si hap tjetër, ndërmerren veprime për zbutjen e rrezikut para se të merret vendimi përfundimtar për ngritjen e një shërbimi të ri. Vlerësimet e rrezikut kryhen më pas në mënyrë periodike për të bërë rregullimet e nevojshme kur kërkohet. Poashtu, vlerësimi i rrezikut kryhet para çdo lloj aktiviteti që mund të lëndojë fëmijët, për shembull, udhëtime apo kampe. Nëse rreziku është shumë i lartë dhe nuk mund të reduktohet, projekti ose aktiviteti nuk zbatohet më tej. Vendimi më pas merret në përputhje me rrethanat nga menaxhmenti i organizatës.

### 6.2.3. Vendosija e projekteve të reja

Kur projektet janë duke u krijuar, të gjithë aktorët duhet të angazhohen: fëmijët, familjet, komunitetet, autoritetet lokale dhe organet e tjera publike vendimmarrëse. Duhet të ndiqen standardet locale/vendore për shërbimet sociale, kur këto ekzistojnë dhe janë ligjërisht të kufizuara me kritere të qarta përzgjedhjeje për të gjithë përdoruesit dhe një numër i përcaktuar i kapaciteteve maksimale të secilit shërbim. Nuk lejohet diskriminim në bazë etnike, religjioze, gjinore etj. gjatë përcaktimit të kritereve për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në program. Të gjitha shërbimet dhe aktivitetet përkatëse u paraqiten të gjithë përdoruesve të programit. Një seminar i detajuar mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e dikujt zhvillohet dhe nënshkruhet një kontratë shërbimi sipas dispozitave ligjore të çdo vendi. Pëlqimi i prindërve ose i kujdestarit ligjor dhe i fëmijës duhet të merret me shkrim sapo të fillojnë projektet ose aktivitetet e reja. Gjithashtu, fëmija dhe prindi/kujdestari/përfaqësuesi ligjor informohen se si mund të raportojnë çdo shkelje të të drejtave të fëmijës dhe pasojat e mundshme të veprimeve të tilla (numri i telefonit të organizatës, personi i besueshëm në çdo qendër dhe detajet e kontaktit të personit përgjegjës (Pika Fokale për Mbrojtjen e Fëmijëve)

### 6.2.4. Partnerët

